

VENDIM
Nr. 80/2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 65/2025, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 21 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikat IV, VI, VII dhe IX, të vendimit nr. 65/2025, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhen këto shtesa:

Deputeti Besart Xhaferi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.

Deputeti Bledion Nallbati caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Deputeti Agron Gjekmarkaj caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

Deputeti Bujar Rexha caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.